




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Tip	Nr. Prot.
Urysi	6: Prot.
Qip	Prot. No.
18.11.2011	01-4551/11
18.11.2011	
18.11.2011	
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datën 19.10.2011 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. protokolli: AKK – 03-171 / 11, i dyshuar për konflikt interesi për Ztr. Ibish Krasniqi – Këshilltar Komunal në Ansamblenë Komunale të Junikut.***
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur të paraqiten rrethana të ngjashme.***

**A r s y e t i m**

Në rastin me nr. protokolli AKK-03-171 / 11, të shqyrtuar për Konflikt të mundshëm Interesi, është vërtetuar se për dyshimin e bazuar për konflikt interesi për zyrtarin Ibish Krasniqi, Këshilltar Komunal në Ansamblenë e Komunës së Junikut nuk ka pasur prova të mjaftueshme që e vërtetojnë këtë situatë. Zyrtari Krasniqi ka sjellur në Agjencionin Kundër Korrupsionit disa shkresa të cilat përmbajnë sqarime për lejimin e punës në institucionin ku punon dhe për të qenë Këshilltar në Ansamblenë Komunale.

Me datën 13.10.2011, z. Ibish Krasniqi në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka sjellur një shkresë "Vërtetim" (Nr.Prot. D.P.02/3981/11) me të cilën institucioni ku ai punon, Drejtoria Rajonale e Agjencionit Pyjor të Kosovës (D.R.APK) përmes Drejtorit, Ibish Blakaj, i lejon atij që të marr pjesë edhe në seancat e rregullta të Kuvendit Komunal të Junikut. Po ashtu me datën 13.10.2011, ztr.Krasniqi përmes Drejtorit për Buxhet e Financa të Komunës së Junikut në posten elektronike të AKK-së ka dërguar dokumentin me të cilin dëshmon se nga Kuvendi Komunal në Junik ai merr vetëm një pjesë nga të ardhurat e tij dhe ato i ka deklaruar si të hyra sekondare.


Edhe në pajtim me nenin 10 pika 1 e Ligjit Nr. 04/L-051 zyrtari i zgjedhur si përfaqesues i partisë politike ruan të drejten e ushtrimit të funksionit në parti politike nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

Prandaj ***në bazë të Ligjit Nr.04/L-051***, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ***neni 18, pika 4 dhe 12***, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) nxjerr këtë vendim me të cilin vendoset si në dispozitiv.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Shefit të Divizionit për P.K.I.
- Zyrtarit në rast
- Zyrtarit përgjegjës

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /